



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS
KËSHILLI KOMBËTAR I TRASHËGIMISË KULTURORE MATERIALE

Nr. 509 Prot.

Tiranë, më datë 22.01.2020

VENDIM

Nr. 37, datë 22.01.2020

Në mbështetje të Ligjit Nr. 27, datë 17.05.2018 “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, neni 48 dhe neni 134 dhe V.K.M Nr. 208, datë 10.04.2019 “Për Përbërjen, Mënyrën e funksionimit, Kompetencat dhe Shpërblimin e Anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale”, pas shqyrtimit më parë në Këshillin Teknik të Institutit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore të projektit dhe raportit të vëzhgimit arkeologjik, Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale, në mbledhjen e datës 22.01.2020,

VENDOSI:

1. Miratimin e projektit “Kompleks rezidencial me banesa 1 dhe 2 kat (banesa 1, 2, 3, 4 dhe 5 kat nëntokë; banesa 6 me 1 kat pjesërisht nëntokë me mur rrethues dhe kabinë elektrike, në Mjull Bathore”, Tiranë, me zhvillues “G. M.” sh.p.k dhe raportin e vëzhgimit arkeologjik të realizuar nga subjekt i licencuar në arkeologji z. Ylli Cerova;
2. Subjekti aplikues duhet të vijojë me procedurën ligjore për miratimin sipas legjislacionit për planifikimin dhe zhvillimin e territorit;
3. Subjekti “G. M.” sh.p.k, duhet të lidhë paraprakisht akt-marrëveshje 3 palëshe me subjekt të licencuar në arkeologji, i cili do të ndjekë në mënyrë periodike ditore kryerjen e punimeve të gërmimit për projektin e kompleksit rezidencial në Mjull Bathore si dhe Institutit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore, i cili do të mbikëqyrë këtë subjekt.
4. Gjatë procesit të zbatimit, siç parashikon dhe legjislacioni për trashëgiminë kulturore, punimet të mbikëqyren sipas Ligjit Nr. 27, datë 17.05.2018, “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, nenet 144-147;
5. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij Vendimi;
6. Ndaj Vendimit mund të ushtrohet ankim në gjykatën kompetente për shqyrtimin e mosmarrëveshjeve administrative. Ankimi nuk pezullon zbatimin e aktit administrativ.

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

SEKRETAR

Arta DOLLANI

KRYETAR

Elva MARGARITI

